



RAPORTI I KONSULTIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2025

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	2
1. Raporti për takimet publike me qytetarë.....	3
2. Raporti për konsultimet publike për projektaktet komunale (takimet konsultative)	5
3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve).....	7
4. Raporti i dëgjimeve buxhetore me qytetarë	9

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Komuna e Mitrovicës ka zhvilluar një sërë aktivitetsesh në kuadër të konsultimeve publike, me qëllim të përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse komunale. Në periudhën e raportimit janë realizuar 2 takime publike, 3 konsultime publike për akte dhe dokumente komunale, si dhe 4 dëgjime buxhetore në kuadër të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe buxhetit vjetor.

Këto aktivitete janë organizuar në objektin e komunës, duke mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve nga lagje dhe fshatra të ndryshme, si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, bizneseve lokale dhe grupeve të tjera të interesit. Një nga sukseset kryesore të këtij procesi ka qenë rritja e transparencës institucionale dhe përfshirja më e gjerë e qytetarëve në diskutimin e çështjeve me interes publik, veçanërisht në procesin e planifikimit buxhetor dhe hartimit të politikave lokale.

Megjithatë, gjatë realizimit të konsultimeve janë hasur edhe disa sfida, si pjesëmarrja e kufizuar e qytetarëve në disa takime, mungesa e interesimit nga grupe të caktuara shoqërore, si dhe kufizime kohore dhe logjistike në organizimin e aktiviteteve në zona më të largëta. Pavarësisht këtyre sfidave, Komuna ka ndërmarrë masa për t'i adresuar ato përmes njoftimeve më të hershme publike dhe përdorimit të kanaleve alternative të komunikimit.

Në përgjithësi, objektivat e konsultimeve publike janë arritur në masë të konsiderueshme, ndërsa obligimet ligjore të parapara me legjislacionin në fuqi për transparencë dhe pjesëmarrje publike janë përmbushur. Rekomandimet dhe sugjerimet e qytetarëve janë shqyrtuar dhe, në rast të caktuara, janë reflektuar në dokumentet përfundimtare dhe vendimet komunale.

1. Raporti për takimet publike me qytetarë

Kryetari i Komunës ka organizuar 2 takime publike të drejtuara nga ai, me qëllim të përfshirjes aktive të qytetarëve në dialogun publik dhe adresimin e çështjeve me interes të përbashkët. Takimet kanë përfshirë dialog me qytetarët për tema të ndryshme lokale (p.sh., prioritetet e qytetit dhe shqetësimet e komunitetit).

Takimet publike janë zhvilluar në Sallën e Kuvendit të Komunës. Në takime janë ftuar dhe kanë marrë pjesë grupe të ndryshme të targetuara, përfshirë përfaqësues të komunitetit, qytetarë aktivë, organizata joqeveritare dhe përfaqësues të bizneseve lokale, me fokus diskutimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin lokal, shërbimet publike, transparencën dhe angazhimin e komunitetit në proceset vendimmarrëse.

Në vijimësi të këtyre takimeve, Komuna ka siguruar publikimin e njoftimeve dhe raportimeve për takimet në faqen zyrtare, duke përmbushur kërkesat për transparencë dhe qasje të lirë të publikut në informacionet zyrtare dhe duke ofruar mundësinë e komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve lokale.

Arritjet, objektivat dhe përmbushja e obligimeve ligjore

Për sa i përket arritjeve kryesore, takimet publike të kryetarit kanë kontribuar në:

- përmirësimin e dialogut institucion-qytetarë dhe rritjen e transparencës së procesit vendimmarrës;
- publikimin e raporteve nga takimet, duke ofruar një dokumentim të detajuar të debateve dhe sugjerimeve;
- krijimin e hapësirës për qytetarët që të shpreheshin drejtpërdrejt për çështje të rëndësishme komunale.

Në aspektin ligjor, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka përmbushur obligimet e parapara me ligjet për transparencë dhe pjesëmarrje publike, duke siguruar:

- publikimin e dokumenteve për konsultim publik dhe njoftimeve për takimet;
- realizimin e takimeve brenda afateve logjistike të nevojshme;
- komunikim të hapur me qytetarët për temat e caktuara që lidhen me politikën vendore.

Megjithatë, si në çdo proces të përfshirjes publike, është vërejtur nevoja për pjesëmarrje edhe më të gjerë dhe më aktive nga të gjitha grupet e komunitetit, si dhe për zgjerim të formave të komunikimit përtej mjediseve tradicionale, për të siguruar që perspektivat e të gjitha shtresave të shoqërisë të jenë të përfshira në vendimmarrje.

Në përgjithësi, objektivat kryesore të konsultimeve dhe takimeve janë arritur në një masë të dukshme, dhe obligimet ligjore për transparencë dhe përfshirje publike janë respektuar në përputhje me normat dhe rregulloret komunale të ndërmarra për vitin 2025.

Tabela 1. Raporti për takimet publike me qytetarë

Tabela e përgjithshme					
Komuna	Numri i takimeve publike me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në takimet publike (në total)	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Mitrovicës së Jugut	2	66	51	15	2

Verifikimi i të dhënave			
Takimi publik	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Takimi i parë publik i Kryetarit me qytetarë për vitin 2025	16.06.2026	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Thirrja-per-takimin-e-pare-publik-te-krvetarit-per-vitin-2025-pdf.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Raport-nga-takimi-i-pare-publik-i-krvetarit-me-qytetare-pe-vitin-2025.pdf
Takimi i dytë publik i Kryetarit me qytetarë për vitin 2025	30.12.2026	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/Tubimi-i-dyte-publik-per-vitin-2025.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/Raport-nga-takimi-i-dyte-publik-i-Krvetarit-me-qytetare-per-vitin-2025.pdf

2. Raporti për konsultimet publike për projekt aktet komunale (takimet konsultative)

Gjatë periudhës së raportimit janë organizuar gjithsej 3 takime konsultative për projekt aktet komunale, në përputhje me obligimin ligjor të përcaktuar nga Neni 26 i UA për Administratë të Hapur në Komuna. Këto takime u zhvilluan në objektin e Kuvendit Komunal, për të siguruar një përfshirje sa më të gjerë të qytetarëve dhe palëve të interesuara.

Grupet e targetuara për këto konsultime përfshin qytetarët e zakonshëm, përfaqësues të bizneseve lokale, organizatat joqeveritare dhe ekspertet e fushave përkatëse. Takimet u organizuan me qëllim për të mbledhur komente dhe rekomandime mbi projekt aktet komunale, si dhe për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje aktive në procesin e hartimit të politikave lokale.

Gjate këtyre konsultimeve, qytetarët shprehën mendimet dhe shqetësimet e tyre lidhur me çështje të rëndësishme. Shumica e sugjerimeve të dhëna gjatë takimeve u morën parasysh gjatë procesit të finalizimit të projekt akteve.

Objektivat e konsultimeve publike u arritën në një masë të kënaqshme, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për proceset vendimmarrëse dhe krijimin e një dialogu të hapur ndërmjet komunitetit dhe administratës komunale.

Në aspektin ligjor, obligimet e përcaktuara për organizimin e këtyre konsultimeve janë përmbushur. Sidoqoftë, janë identifikuar disa sfida, përfshirë vështirësitë në njoftimin e qytetarëve për takimet dhe pjesëmarrjen e ulët në disa zona. Në përgjithësi, këto takime konsultative kanë kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe forcimin e partneritetit me qytetarët.

Tabela 2. Raporti për konsultimet publike për projekt aktet komunale (takimet konsultative)

Tabela e përgjithshme								
Komuna	Plani i konsultimeve është hartuar dhe publikuar në fillim të vitit (PO/JO)	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projekt akteve për të cilat është organizuar konsultim publik	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (total) (M . F)		Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara
Komuna e Mitrovicës së Jugut	Po, https://mitrovicetrajguc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-Dokumente-ve-per-Konsultime-	3	3	14	12	26	26	3

	Takime-Publike-dhe-Degjime-Buxhetore-per-vitin-2025-pdf.pdf							
--	---	--	--	--	--	--	--	--

Verifikimi i të dhënave			
Emërtimi i Projekt aktit	Data e mbajtjes së konsultimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i publikimit të raportit
KAB 2026-2028	11.06.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftim-KAB-2026-2028-konsultim-publik.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/Procesverbal-nga-Konsultimi-Publik-per-Kornizen-Afatmesme-Buxhetore-2026-2028.pdf
Projekt – Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut / 2025-2029	24.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-Konsultim-Publik-Rregullorja-per-Transparence-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-nga-Konsultimi-Publik-Rregullorja-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence-ne-Komunen-e-Mitrovices-se-Jugut-f.pdf
Projekt-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut	24.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-Konsultim-Publik-Rregullorja-per-Transparence-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-nga-Konsultimi-Publik-Rregullorja-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence-ne-Komunen-e-Mitrovices-se-Jugut-f.pdf

3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike (përdorimi i platformës së konsultimeve publike dhe ueb faqes zyrtare të komunës)

Komuna e Mitrovicës ka realizuar 3 konsultime publike me shkrim dhe në formë elektronike për projekt-akte komunale. Këto konsultime janë zhvilluar kryesisht përmes ueb-faqes zyrtare të komunës, si dhe përmes platformës për konsultime publike, duke u mundësuar qytetarëve dhe palëve të interesit qasje të hapur në draft-dokumente dhe mundësi për dhënie të komenteve dhe rekomandimeve.

Objektivat kryesore të këtyre konsultimeve ishin të siguronin një proces më të hapur dhe gjithëpërfshirës të hartimit të politikave, duke u ofruar qytetarëve një mundësi të drejtpërdrejtë për të kontribuar me idetë e tyre. Në përgjithësi, këto objektiva u arritën, megjithëse pjesëmarrja elektronike mbeti e kufizuar në disa grupe shoqërore për shkak të mungesës së aksesit në teknologji apo njohurive për përdorimin e platformave online.

Në aspektin ligjor, janë përmbushur obligimet për organizimin e konsultimeve publike në këtë format. Si pjesë e përmirësimeve të ardhshme, rekomandohet që të investohet në promovimin më të mirë të këtyre mekanizmave dhe ofrimin e udhëzimeve për përdorimin e tyre nga qytetarët.

Konsultimet publike me shkrim dhe elektronike kanë ndihmuar në forcimin e lidhjes ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve, duke krijuar një hapësirë të sigurt dhe transparente për komunikim dhe vendimmarrje të përbashkët.

Konsultimet publike me shkrim dhe elektronike janë realizuar përmes:

- publikimit të projekt-akteve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës;
- njoftimeve publike për afatet e konsultimit dhe mënyrën e parashtrimit të komenteve;
- pranimit të komenteve përmes platformave elektronike dhe komunikimit zyrtar me shkrim.

Tabela 3. Raporti për konsultimet publike me shkrim apo elektronike për projekt aktet komunale (përdorimi i platformës së konsultimeve publike dhe në ueb të komunës)

Tabela e përgjithshme					
Komuna	Numri total i akteve komunale të miratuara, për të cilat kërkohet organizimi i konsultimit publik	Numri i projekt akteve për të cilat është organizuar konsultim publik në platformën e konsultimeve	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar komente gjatë konsultimit	Numri i rekomandimeve/propozimeve të pjesëmarrësve të aprovuara	Numri i raporteve të konsultimit të hartuara dhe publikuara në platformën e konsultimeve
Komuna e Mitrovicës	3	3	26	26	3

Verifikimi i të dhënave			
Emërtimi i Projekt aktit	Data e fillimit të konsultimit	Linku i konsultimit (platforma e konsultimeve, ueb-i i Komunës)	Linku i publikimit të raportit
KAB 2026-2028	30.05.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/KAB-KOMUNAL-2026-2028.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/Procesverbalnga-Konsultimi-Publik-per-Kornizen-Afatesme-Buxhetore-2026-2028.pdf
Projekt – Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut / 2025-2029	24.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Plani-i-veprimit-per-transparence-ne-Komunen-e-Mitrovices-se-Jugut-2025-2029.docx https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-Konsultim-Publik-Rregullorja-per-Transparence-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-nga-Konsultimi-Publik-Rregullorja-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence-ne-Komunen-e-Mitrovices-se-Jugut-f.pdf
Projekt-Rregullorja për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut	24.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/RREGULLORJA-PER-TRANSPARENCE-NE-KOMUNEN-E-MITROVICES-SE-JUGUT-Finale.docx https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftimi-per-Konsultim-Publik-Rregullorja-per-Transparence-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-nga-Konsultimi-Publik-Rregullorja-dhe-Plani-i-Veprimit-per-Transparence-ne-Komunen-e-Mitrovices-se-Jugut-f.pdf

4. Raporti i dëgjimeve buxhetore me qytetarë

Komuna e Mitrovicës ka organizuar dëgjime buxhetore me qytetarë në kuadër të procesit të planifikimit buxhetor, përfshirë Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), Draftin e Buxhetit Komunal dhe elemente të buxhetimit me pjesëmarrje. Këto dëgjime janë realizuar në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe përfshirje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes financiare lokale.

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPI) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkores 2024/01, Grupi Punues për dëgjime buxhetore 2026-2028 ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore për pranimin e kërkesave të qytetarëve për buxhetin e vitin 2026 dhe planifikimin për vitet 2027 dhe 2028.

Në procesin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2025-2027 i kemi përfshirë gjithsej 5 dëgjime buxhetore, prej të cilave dëgjimi i parë ka qenë për KAB – Komunal 2026-2028 dhe katër dëgjime për planifikimin e buxhetit komunal 2026-2028.

Dëgjime buxhetore kanë qenë tematike dhe të përgjithshme, të lokusuara në:

- prezantimin e Draft-Buxhetit Komunal për vitin 2025;
- diskutimin e prioritetëve buxhetore në kuadër të Kornizës Afatmesme Buxhetore;
- mbledhjen e propozimeve përmes qasjes së buxhetimit me pjesëmarrje, duke përfshirë grupe të ndryshme të qytetarëve.

Dëgjimet janë organizuar në forma të ndryshme, duke synuar përfshirjen sa më të gjerë të komunitetit lokal.

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe grupet e përfshira

Në dëgjimet buxhetore të vitit 2025 kanë marrë pjesë:

- qytetarë të Komunës së Mitrovicës;
- përfaqësues të këshillave të fshatrave dhe lagjeve;
- grupe të veçanta të shoqërisë, përfshirë gra, vajza, të rinj dhe komunitete jo-shumicë;
- përfaqësues të shoqërisë civile dhe sektorëve të interesit.

Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të informohen drejtpërdrejt për strukturën e buxhetit, kufizimet financiare dhe prioritetet zhvillimore të komunës, si dhe të parashtrijnë komente dhe rekomandime.

Komentet dhe rekomandimet e pranuar

Gjatë dëgjimeve buxhetore janë pranuar komente dhe propozime të ndryshme nga qytetarët pjesëmarrës, të cilat kanë qenë të orientuara kryesisht në:

- investime kapitale në infrastrukturë lokale;
- përmirësimin e shërbimeve publike;
- mbështetjen për sektorë të caktuar si arsimi, kultura, rinia dhe mirëqenia sociale.

Komentet janë evidentuar nga zyrtarët përgjegjës dhe janë trajtuar në kuadër të procesit të finalizimit të dokumenteve buxhetore, në përputhje me mundësitë financiare dhe prioritetet strategjike të komunës.

Mënyra e organizimit dhe transparencja

Dëgjimet buxhetore janë njoftuar paraprakisht përmes ueb-faqes zyrtare të Komunës së Mitrovicës, duke siguruar transparencë dhe informim të publikut për kohën, vendin dhe qëllimin e tyre. Organizimi i dëgjimeve ka kontribuar në krijimin e një dialogu të drejtpërdrejtë ndërmjet qytetarëve dhe institucionit komunal.

Arritja e objektivave dhe përmbushja e obligimeve ligjore

Objektivi kryesor i dëgjimeve buxhetore për vitin 2025 ka qenë:

- rritja e transparencës në planifikimin buxhetor;
- përfshirja e qytetarëve në përcaktimin e prioritetëve lokale;
- forcimi i llogaridhënies dhe besimit ndërmjet komunës dhe qytetarëve.

Bazuar në numrin e dëgjimeve të organizuara dhe në përfshirjen e qytetarëve në proces, Komuna e Mitrovicës ka përmbushur obligimet ligjore për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën e administratës së hapur. Dëgjimet kanë kontribuar në një proces më gjithëpërfshirës dhe transparent të hartimit të buxhetit komunal për vitin 2025.

Tabela 4. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë për KAB

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuara	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Mitrovicës së Jugut	1	17	4	4	10	7	1

Verifikimi i të dhënave			
Dëgjimi buxhetor për KAB	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Korniza Afatmesme Buxhetore 2026- 2028	11.06.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftim-KAB-2026-2028-konsultim-publik.pdf	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/01/Procesverba-l-nga-Konsultimi-Publik-per-Kornizen-Afatmesme-Buxhetore-2026-2028.pdf

Tabela 5. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë për Draft buxhetin

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve
Komuna e Mitrovicës së Jugut	4	146	39	52	32	41	2

Verifikimi i të dhënave			
Dëgjimi buxhetor për Draft Buxhetin	Data e takimit	Linku i njoftimit të publikuar	Linku i procesverbalit
Dëgjimi i parë buxhetor me kryetarët e këshillave të fshatrave	08.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/event/ftese-per-degjimin-e-pare-buxhetor-me-krvetaret-e-keshillave-te-fshatrave/	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Buxhetin-e-viteve-2026-2028.pdf
Dëgjimi i dytë buxhetor me shoqëritë civile dhe komunitetin artistik	09.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/event/ftese-per-degjimin-e-dyte-buxhetor-me-shoqerit-civile-dhe-komunitetit-artistik/	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Buxhetin-e-viteve-2026-2028.pdf
Dëgjimi i tretë buxhetor me gratë dhe vajzat	11.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/event/ftese-per-degjimin-e-trete-buxhetor-me-grate-dhe-vjazat/	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Buxhetin-e-viteve-2026-2028.pdf
Dëgjimi i katërt buxhetor me komunitetin jo shumicë	16.07.2025	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/event/ftese-per-degjimin-e-katerte-buxhetor-me-komunitetin-jo-shumice/	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Raport-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Buxhetin-e-viteve-2026-2028.pdf

Tabela 6. Raporti për dëgjimet buxhetore me qytetarë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje

Tabela e përgjithshme							
Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore me qytetarë të organizuara	Numri i pjesëmarrësve në dëgjime buxhetore (në total)	Numri i pjesëmarrësve që kanë ofruar propozime	Numri i propozimeve të pranuar	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë (M. / F)		Numri i procesverbaleve të hartuara dhe publikuara pas takimeve

Komuna e Mitrovicë së Jugut	https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Orari-i-degjimeve-buxhetore-me-qytetare-per-planifikimin-e-buxhetit-per-vitet-2026-2028-1.pdf https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Njoftim-KAB-2026-2028-konsultim-publik.pdf	163	43	56	42	48	2
-----------------------------	--	-----	----	----	----	----	---

Sofije Rushiti Peci

Zyrtare për Informim- Zyra për Komunikim me Publikun

